



- Të Reja ▾Policia e Shtetit ▾Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptarShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjet e policisëVideo
- Programi i transparencës ▾KontaktDenonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore të Policisë ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾
- DonacioneRubrika Policimi në Komunitet ▾Përmbledhja JavorePër sinjalizimin

Breaking News: Sarandë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Koordinatat”

Tiranë – Finalizohet nga Komisariati i Policisë Nr. 6, operacioni policor i koduar “Recidivisti”

Tiranë – Përdori celularin gjatë drejtimit të autobusit, ndëshkohet me gjobë drejtuesi

DVP Dibër/Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër

Sarandë – Vihen në pranga 2 shtetas



LajmetOperacionet

30/08/2023

Tiranë – Finalizohet Nga Komisariati I Policisë Nr. 6, Operacioni Policor I Koduar “Recidivisti”

Tiranë

Finalizohet nga Komisariati i Policisë Nr. 6, operacioni policor i koduar “Recidivisti”.

Theu masën e sigurisë “Arrest në shtëpi” për veprën penale “Podhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe u kap në flagrancë me një sasi kokaine, vihet në pranga 37-vjeçari, i dënuar më parë për të njëjtën veprimtari kriminale.

Gjatë kontrollit në banesën e 37-vjeçarit, u gjet 1 armë zjarri pistoletë me krehër me municion luftarak.

Sekuestrohen arma e zjarrit pistoletë, një sasi lënde e dyshuar narkotike kokainë dhe një peshore elektronike.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6, në vijim të punës për evidentimin dhe goditjen e veprimtarive kriminale, pas informacioneve të siguruara për një shtetas që shpërndante lëndë narkotike kokainë, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Recidivisti”.

Si rezultat, u arrestua shtetasi M. G., 37 vjeç, banues në Tiranë, i dënuar më parë për vepra penale në fushën e narkotikëve.

Shtetasi M. G. është ndaluar nga shërbimet e Policisë, në rrugën “Foto Xhavela”, dhe gjatë kontrollit fizik, i është gjetur një sasi lënde e dyshuar narkotike e llojit kokainë.

Pas verifikimeve ka rezultuar se 37-vjeçari kishte thyer masën e sigurisë “Arrest në shtëpi”, për veprën penale “Podhimi dhe shitja e narkotikëve”.

Në vijim të veprimeve, gjatë kontrollit në banesën e këtij shtetasi, u gjet një armë zjarri pistoletë me krehër me municion luftarak, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, së bashku me lëndën narkotike kokainë dhe një peshore elektronike.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për veprime të mëtejshme procedurale.

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Tiranë – Përdori celularin gjatë drejtimit të autobusit, ndëshkohet me gjobë drejtuesi

Sarandë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Koordinatat” ▶